



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KËRKESË PËR OFERTË PËR HARTIMIN E METODOLOGJISË SË MONITORIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT GJATË PANDEMISË

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) po zbaton nismën “**Monitorimi i të drejtave dhe lirive themelore gjatë pandemisë globale Covid-19 dhe fuqizimi i shoqërisë civile në Shqipëri,**” mbështetur financiarisht nga the Balkan Trust for Democracy dhe USAID.

Kjo nisëm synon të monitorojë kufizimet ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut që u kryen gjatë pandemisë Covid-19, duke u fokusuar më së shumti ndaj të drejtave social-ekonomike dhe të edukimit, si dhe lirisë së lëvizjes dhe tubimit. Në kuadër të këtij synimi, një ndër aktivitetet thelbësore të nismës përfshin mbledhjen e të dhënave nga qytetarët dhe institucionet nëpërmjet pyetësorëve dhe përgatitjen e një raporti bazuar mbi këto të dhëna. KShH shpall kërkesën për ofertë për ekspertë për t’u angazhuar në **hartimin e metodologjisë së monitorimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë pandemisë Covid-19.**

KShH nxit aplikimet nga kandidatët të cilët plotësojnë karakteristikat e mëposhtme:

Aftësi individuale

- Të jetë i/e pavarur dhe i/e paanshëm/e
- Të gëzojë integritet profesional e moral
- Të ketë aftësi shumë të mira analitike dhe mendimi kritik
- Të respektojë detyrat dhe afatet e vendosura nga ekipi zbatues i projektit
- Të jetë i/e aftë të punojë nën presionin e kohës

Aftësi profesionale

- Të ketë përfunduar studimet në Drejtësi;
- Të ketë përvojë profesionale prej të paktën 5 vitesh në organizata të shoqërisë civile;
- Të ketë njohuri shumë të mira në fushën e të drejtave të njeriut;
- Të jetë angazhuar më parë në hartimin e metodologjive të monitorimit në fushën e të drejtave të njeriut.

KShH fton ekspertët e interesuar të dërgojnë në rrugë postare dokumentacionin e mëposhtëm deri më datë 7 Qershor 2021:

1. CV
2. Concept note të metodologjisë
3. Letër motivimi



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

4. Ofertë financiare